

#Kongresi



2020

Datë: **28 | 29 | 01**

**DRAFT
STATUTI**

PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË

[Shqiptaria .com]



□□□□□h□□□□□□□□

I PARTISË SOCIALISTE

7 É 6+ 4 ,3 É5 ,6 É

Shkurt 2020

PREAMBUL - DEKLARATA E PARIMEVE

PJESA E PARË.

PARIMET THEMELORE DHE DOKUMENTET BAZË TË PARTISË SOCIALISTE

Kreu 1 - PARIMET THEMELORE

- Neni 1 Partia Socialiste e Shqipërisë
- Neni 2 Qëllimi dhe vlerat themelore
- Neni 3 Demokracia e brendshme
- Neni 4 Liria e mendimit
- Neni 5 Liria e zgjedhjes dhe fshehtësia e votës
- Neni 6 E drejta e mbrojtjes së dinjitetit
- Neni 7 Kolegjialiteti, inisiativa dhe profesionalizmi
- Neni 8 Zgjedhja, promovimi dhe konkurrimi në parti
- Neni 9 Transparenca dhe llogaridhënia

Kreu 2 - DOKUMENTET BAZË DHE SIMBOLI

- Neni 10 Emri
- Neni 11 Dokumentet themelore të Partisë Socialiste
- Neni 12 Simboli, stema, flamuri i Partisë Socialiste
- Neni 13 Regjistri i partisë
- Neni 14 Internacionalja Socialiste dhe Partia e Socialistëve Europianë

PJESA E DYTË.

ANËTARËSIA E PARTISË SOCIALISTE

Kreu 3 - ANËTARËSIA DHE RREGULLAT E ANËTARËSIMIT

- Neni 15 E drejta e antarësisë
- Neni 16 Pranimi në parti
- Neni 17 Të drejtat e antarit të partisë
- Neni 18 Detyrat e antarit të partisë
- Neni 19 Ndërprerja e përkohshme dhe e përhershme e antarësisë
- Neni 20 Përkrahësi i Partisë Socialiste

Kreu 4 - RREGULLAT DISIPLINORE TË PARTISË

- Neni 21 Qëllimi i rregullave disiplinore
- Neni 22 Masat disiplinore

PJESA E TRETË.

RREGULLAT E ORGANIZIMIT TË PARTISË SOCIALISTE

Kreu 5 - STRUKTURAT E PARTISË NË NIVEL VENDOR

1.1. ORGANIZATA SOCIALISTE

- Neni 23 Organizata Socialiste

1.2. ORGANIZIMI I PARTISË NË NJËSINË ADMINISTRATIVE

- Neni 24 Këshilli Socialist i Njësisë Administrative

1.3. ORGANIZIMI I PARTISË NË BASHKI

- Neni 25 Asambleja Socialiste e Bashkisë
- Neni 26 Kryetari i partisë i bashkisë

1.4. ORGANIZIMI I PARTISË NË RAJON DHE QARK

Neni 27 Organet e partisë në Rajon dhe Qark

Neni 28 Strukturat koordinuese elektorale

1.5. ORGANIZIMI I PARTISË JASHTË VENDIT

Neni 29 Strukturat e partisë jashtë vendit

Kreu 6.

ORGANET DREJTUESE QENDRORE

Neni 30 Organet drejtuese e përfaqësuese të partisë në nivel qendror

Neni 31 Kongresi i Partisë Socialiste

Neni 32 Delegatët e Kongresit

Neni 33 Kompetencat e Kongresit të Partisë

Neni 34 Kryetari i Partisë Socialiste

Neni 35 Zgjedhja e Kryetarit të Partisë

Neni 36 Asambleja Kombëtare e Partisë, përbërja, drejtimi

Neni 37 Detyrat e Asamblesë Kombëtare të Partisë

Neni 38 Kryesia e Partisë Socialiste, përbërja, drejtimi, funksionimi

Neni 39 Sekretari i Përgjithshëm i Partisë

Neni 40 Sekretariati Ekzekutiv i Partisë

Neni 41 Komisioni i Garancive Statutore dhe Etikës (KGSE)

Neni 42 Komisioni i Zgjedhjeve në Parti (KZP)

PJESA E KATËRT.

PËRFAQËSUESIT E PARTISË NË DEGËT E QEVERISJES

Kreu 7 - RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 43 Përfaqësimi

Neni 44 Parimet e zgjedhjes së përfaqësuesve të partisë në organet e qeverisjes

Neni 45 Integriteti dhe standartet në përzgjedhjen e kandidatëve

Neni 46 Kodi i Etikës

Neni 47 Marrëdhëniet e partisë me organet e qeverisjes qendrore e vendore

Neni 48 Papajtueshmëria me detyrën e kryetarit të partisë në nivel vendor

Kreu 8 - PËRFAQËSUESIT E PARTISË NË ORGANET E QEVERISJES

QENDRORE

Neni 49 Grupi Parlamentar Socialist

Neni 50 Përfaqësuesit e partisë në strukturat drejtuese të Kuvendit

Neni 51 Zgjedhja e kandidatëve për deputetë

Neni 52 Përfaqësuesit e partisë në degën ekzekutive të qeverisjes

Kreu 9 - PËRFAQËSUESIT E PARTISË NË ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Neni 53 Grupet e këshilltarëve socialistë

Neni 54 Përfaqësuesit e partisë për kryetar bashkie dhe kryetar qarku

Neni 55 Zgjedhja ndërmjet individëve kandidatë

PJESA E PESTË.

RREGULLAT PROCEDURIALE TË PARTISË SOCIALISTE

Kreu 10 - VENDIMARRJA NË PARTI

Neni 56 Zhvillimi i mbledhjeve në parti

Neni 57 Marrja e vendimit

Neni 58 Zbatimi i vendimit

Kreu 11 – VOTIMI DHE VOTËBESIMI

Neni 59 Votimi

Neni 60 Votëbesimi

Neni 61 Referendumi dhe forma të tjera të konsultimit

PJESA E GJASHTË.

MARRDHËNIET E PARTISË ME ORGANIZATAT POLITIKE E SHOQËRORE

Kreu 12 - MARRDHËNIET ME ORGANIZMAT POLITIKË BRENDIA SAJ

Neni 62 Forumi i Rinisë Eurosocialiste të Shqipërisë (FRESSH)

Neni 63 Forumi i Gruas Socialiste të Shqipërisë (FGSSH)

Neni 64 Fondacioni “Qemal Stafa”

Kreu 13 - MARRDHËNIET ME ORGANIZATAT E TJERA DHE MJETET E INFORMIMIT PUBLIK

Neni 65 Marrëdhëniet me organizatat e tjera

Neni 66 Shtypi dhe mjetet e tjera të partisë për informimin publik

PJESA E SHTATË.

FINANCAT, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I TYRE

Kreu 14 - BURIMET FINANCIARE E MATERIALE

Neni 67 Burimet financiare e materiale

Neni 68 Kuota e anëtarësimit

Neni 69 Dhuratat

Neni 70 Përdorimi i burimeve financiare e materiale dhe kontrolli i tyre

Neni 71 Transparenca financiare

Neni 72 Auditimi ligjor

PJESA E TETË.

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 72 Hyrja në fuqi

Neni 73 Rregulloret e zbatimi

PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË (PS)

PREAMBUL

DEKLARATA E PARIMEVE

Ne, anëtarët dhe përkrahësit e Partisë Socialiste të Shqipërisë, me angazhimin për të respektuar, mbrojtur dhe promovuar vlerat e barazisë, lirisë, solidaritetit, drejtësisë e paqes, që përbëjnë themelet e socializmit demokratik.

Si bartës të vlerave më të mira kombëtare shqiptare dhe të mendimit progresiv bashkëkohor ndërkombëtar.

Bazuar në parimet e lirisë, drejtësisë sociale, barazisë së shanseve dhe solidaritetin njerëzor; respektimin e të drejtave të të gjithë qytetarëve dhe kujdesjen që çdonjëri të përmbushë detyrat; mbrojtjen e pluralizmit; promovimin e mundësive të barabarta për gratë, vajzat dhe rininë; forcimin e shtetit të së drejtës, respektimin e Kushtetutës, akteve ndërkombëtare dhe të ligjeve të tjera të Republikës së Shqipërisë, respektimin e ndarjes së pushteteve dhe garantimin e një qeverisjeje të përgjegjshme si kontratë mes qytetarësh të lirë, decentralizimin si një ekuilibër midis qeverisjes efektive qendrore dhe demokracisë lokale të gjallë dhe novatore.

Me qëllim ndërtimin e një shoqërie të re, më të mirë, e cila respekton dinjitetin e individit, të drejtat dhe liritë e njeriut, kundër të gjitha formave të diskriminimit: ekonomik, politik, social, etnik, fetar, moshor, gjinor, seksual, gjuhësor, arsimor dhe të aftësisë së kufizuar; një shoqëri e sigurtë, e cila krijon mirëqenie, mbron familjen dhe të dobët, nxit mundësitë, të drejtat dhe detyrimet e barabarta, i çliron njerëzit nga tirania e varfërisë dhe abuzimet e pushtetit, kundër padrejtësive dhe dhunës, një shoqëri ku barazia dhe liria janë të pandashme;

Me dëshirën për ndërtimin e një shteti të fortë, demokratik dhe social, me një ekonomi bazuar mbi parimet e ekonomisë së tregut të lirë, që zhvillohet duke mbrojtur mjedisin, territorin dhe pasuritë kombëtare, duke sjellë punësim dhe mirqenie, që mbron çdo individ nga rreziqet, papunësia, sëmundjet, vetmia, mosha e mitur apo e thyer, kriminaliteti dhe dhuna;

Me besimin se nëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta mund të arrijmë më shumë sesa arrijmë individualisht; se së bashku mund të ndërtojmë një komunitet në të cilin pushteti, pasuria dhe mundësitë për zhvillim janë në duart e shumicës dhe jo të pakicës; ku të drejtat që gëzojmë burojnë nga detyrimet që kemi; ku të gjithë jetojmë lirisht në frymën e humanizmit, solidaritetit, tolerancës dhe respektit.

Duke u betuar tek flamuri kombëtar dhe me vullnetin për ta bërë Shqipërinë një vend të begatë, demokratik, të integruar në organizatat më demokratike ndërkombëtare dhe të respektuar në botë, që lufton për paqen, të drejtat e njeriut dhe progresin;

Vendosim këtë Statut, të pranuar nga të gjithë ne, anëtarët, dhe përkrahësit e Partisë Socialiste të Shqipërisë.

PJESA E PARË
PARIMET THEMELORE DHE DOKUMENTET
BAZË TË PARTISË SOCIALISTE (PS)

Kreu 1

PARIMET THEMELORE

Neni 1

Partia Socialiste e Shqipërisë

Partia Socialiste e Shqipërisë është parti elektorale dhe funksionale. Partia Socialiste e Shqipërisë është organizatë politike, e pavarur dhe e hapur që bashkon mbi baza vullnetare shtetas të Republikës së Shqipërisë brenda e jashtë atdheut. Antarët dhe përkrahësit e saj marrin pjesë aktive në veprimtarinë politike dhe shoqërore të vendit.

Neni 2

Qëllimi dhe vlerat themelore

1. Deklarata e Parimeve shpreh vlerat themelore të partisë dhe përbën Preambulën e Statutit të saj.
2. Qëllimi i partisë është të organizojë dhe të përfaqësojë në shoqëri, në qeverisjen e vendit dhe në arenën ndërkombëtare një parti politike socialiste shqiptare.
3. Për realizimin e parimeve, qëllimeve dhe vlerave themelore të partisë, socialistët bashkëpunojnë me forca politike përparimtare, organizata, sindikata, shoqata dhe grupe interesi, brenda dhe jashtë vendit

Neni 3

Demokracia e brendshme

1. Demokracia e brendshme është parim politik dhe moral i ekzistencës dhe zhvillimit të parties .
2. Organet drejtuese të partisë përfaqësojnë dhe shërbejnë vullnetin e antarëve dhe përkrahësve të saj.
1. 3.Partia Socialiste në veprimtarinë e saj harmonizon demokracinë e drejtperdrejte me demokracinë përfaqësuese. Antari i partisë e shpreh vullnetin drejtpërdrejt ose me delegim. Delegatët zgjedhës, si rregull, kanë mandat me kohëzgjatje të njëjtë me të zgjedhurit prej tyre.
3. Partia Socialiste garanton shanse të barabarta në përfaqësim midis grave dhe burrave. Fjalët e përdorura në këtë statut nënkuptojnë dhe përfshijnë të dyja gjinitë.
4. Organet drejtuese qendrore tërheqin dhe parashirojnë mendimin e organeve drejtuese vendore.
5. Në çdo forum vendimarrës, numri i antarëve të zgjedhur nga partia duhet të jetë më i madh se numri i atyre që hyjnë drejtpërdrejt (*ex officio*) për shkak të statusit të tyre.

Neni 4

Liria e mendimit

1. Partia garanton dhe mbron lirinë e shprehjes së mendimeve dhe platformave të paraqitura nga të gjithë anëtarët e saj, të cilat synojnë zbatimin dhe përmirësimin e Programit, të Statutit dhe demokratizimin e veprimtarisë së partisë.
2. Të zgjedhurit në organet drejtuese të partisë tërheqin dhe vlerësojnë mendimin e zgjedhësve të tyre, përfshirë edhe mendimin ndryshe.
3. Organet drejtuese të partisë shqyrtojnë dhe u japin përgjigje antarëve të partisë për çdo propozim ose ankesë që parashtrajnë, jo më vonë se një muaj nga data e parashtrimit.

Neni 5

Liria e zgjedhjes dhe fshehtësia e votes

Partia garanton dhe mbron lirinë e zgjedhjes dhe votimin e fshehtë, si dhe krijon të gjitha kushtet për ushtrimin e këtyre të drejtave.

Neni 6

E drejta e mbrojtjes së dinjitetit

Personaliteti dhe autoriteti i antarit të partisë janë të pacënueshëm. Çdo antar i partisë ka të drejtë të mbrojtë dinjitetin e tij në të gjitha forumet e partisë. Asnjë antar partie nuk mund të privohet nga gëzimi i të drejtave të tij në parti pa një vendim të formës së prerë të organeve gjyqësore ose organeve të garancisë statutore dhe etikës.

Neni 7

Kolegjialiteti, inisiativa dhe profesionalizmi

1. Drejtimi i Partisë në çdo nivel të saj është kolegjial. Organizatat socialiste dhe organet drejtuese në veprimtarinë e tyre zbatojnë parimin e kolegjialitetit.
2. Partia tërheq mendimin e kualifikuar profesional në çdo vendim dhe qëndrim politik.
3. Antarët dhe strukturat e partisë vetveprojnë në bazë të Programit dhe të Statutit të partisë.
4. Inisiativa personale, e shprehur në emër të partisë, duhet të jetë në përputhje me Programin, Statutin dhe Librin e Rregullave.

Neni 8

Zgjedhja, promovimi dhe konkurimi në parti

1. Kariera e çdo antari të partisë bazohet në meritën individuale, kontributin në parti dhe shoqëri, si dhe integritetin ligjor e moral.
2. Për çdo detyrë përfaqësuese politike në parti dhe në emër të saj zhvillohet proces konkurimi transparent, i mbështetur në rregullat statutore të partisë.
3. Në procesin e propozimeve dhe zgjedhjeve për drejtues të forumeve të partisë si dhe për individë të zgjedhur ose të emëruar si përfaqësues të partisë në organet e pushtetit, si rregull, ndiqet parimi i mosmbajtjes së dy mandateve njëkohësisht nga i njëjti person.
4. Në zgjedhjen e drejtuesve, përfaqësuesve dhe vendimmarrjet e partisë në të gjitha nivelet zbatohet parimi i shmangjes së konfliktit të interesave dhe nepotizmit.
5. Rregullat për papajtueshmërinë e mandateve, shmangjen e konfliktit të interesave dhe nepotizmit në drejtim e përfaqësimit përcaktohen në Librin e Rregullave

6. Organet dhe drejtuesit e partisë zgjidhen nëpërmjet një procesi zgjedhor të drejtë dhe transparent, në përputhje me rregullat e Statutit të partisë, udhëzimet dhe afatet kohore të vendosura në Librin e Rregullave.

Neni 9

Transparenca dhe llogaridhënia

1. Veprimtaria e organeve drejtuese të partisë është e hapur për antarët e saj. Dokumentet që pasqyrojnë këtë veprimtari dhe vendimet që merren u bëhen të njohura antarëve të partisë nëpërmjet strukturave organizative, shtypit, faqes *online* dhe mjeteve të tjera të informimit publik të partisë.
2. Organet drejtuese raportojnë para antarëve të partisë.
3. Organet drejtuese qendrore raportojnë para organeve drejtuese vendore dhe anasjelltas.
4. Të zgjedhurit në organet drejtuese të partisë kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e strukturave të partisë dhe të shfrytëzojnë materialet e nevojshme dokumentare.
5. Mbledhjet e strukturave dhe të forumeve drejtuese të partisë bëhen transparente për opinionin publik.
6. Partia informon rregullisht publikun dhe antarët për veprimtarinë dhe vendimet e saj.
7. Organet e shtypit, faqja *online* dhe mjetet e tjera për informim publik të partisë e bazojnë veprimtarinë e tyre në Programin dhe Statutin, duke garantuar autonominë, lirinë e informimit dhe lirinë e mendimit.

Kreu 2

DOKUMENTET BAZË DHE SIMBOLI

Neni 10

Emri

Organizata, veprimtaria e të cilës rregullohet me këtë Statut, quhet Partia Socialiste e Shqipërisë, me gërma nistore “PS”.

Neni 11

Dokumentet themelore të Partisë Socialiste

1. Statuti është akti themelor i parimeve dhe organizimit të partisë.
2. Programi është dokumenti ku përfshihen idetë, parimet e detajuara, strategjia dhe vizioni politik i partisë, dhe miratohet dhe vihet në zbatim në bazë të parimeve e normave, të cilat paraqiten të përmbledhura në Statut. Zbatimi i Programit realizohet përmes veprimtarisë politike si dhe programeve qeverisëse në nivel qendror e vendor.
3. Libri i Rregullave përfshin të gjithë aktet normative të miratuara nga Asambleja Kombëtare, në përputhje me Statutin.
4. Kodi i Etikës përmban normat e moralit dhe të sjelljes së anëtarit të partisë.
5. Programi dhe Statuti miratohen nga Kongresi i Partisë. Programi dhe Statuti përmbledhin mendimin e përbashkët të antarëve të partisë dhe janë dokumentet bazë për çdo antar në marrëdhëniet e tij me partinë. Libri i Rregullave dhe Kodi i Etikës miratohen nga Asambleja Kombëtare.

Neni 12

Simboli, stema, flamuri i Partisë Socialiste

1. Simboli i Partisë Socialiste paraqet një grusht të mbledhur, i cili mban një trëndafil të kuq. Simboli vendoset në vulën, stemën dhe flamurin e partisë.
2. Stema e Partisë Socialiste është në formë rrethi me ngjyrë të gjelbër, në qendër vendoset simboli i partisë, ndërsa anash tij është shkruar me gërma kapitale të bardha PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË 1991.
3. Flamuri i Partisë Socialiste është ngjyrë rozë me stemën e partisë në mes.
4. Të drejtën e përdorimit të simboleve të partisë e kanë vetëm institucionet përfaqësuese të partisë në nivel qendror e vendor.
5. Në çdo tubim publik të organizuar në emër të Partisë Socialiste është i detyrueshëm përdorimi i flamurit kombëtar dhe simboleve të saj.
6. Simbolet elektorale përcaktohen e miratohen nga Asamblea Kombëtare

Neni 13

Regjistri i partisë

1. Në parti krijohet Regjistri Elektronik Kombëtar i antarësisë, i cili pasqyron tërësinë e antarësisë së partisë. Regjistri përmban listën e antarëve të partisë, organizatat ku bëjnë pjesë dhe të dhëna të tjera të domosdoshme.
2. Regjistri përmban antarësinë në vite të PS dhe antarësinë efektive vjetore të saj.
3. Lista e antarësisë mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti.
4. Mënyra e mbajtjes së regjistrit, përditësimi, përdorimi nga strukturat e partisë dhe ruajtja e të dhënave personale të antarëve të partisë përcaktohen në Librin e Rregullave, të miratuar nga Asambleja Kombëtare e Partisë Socialiste.

Neni 14

Internacionalja Socialiste dhe Partia e Socialistëve Europianë

Partia Socialiste e Shqipërisë është antare e asociuar e Partisë së Socialistëve Europianë (PSE) dhe antare e Internacionales Socialiste (IS).

PJESA E DYTË

ANËTARËSIA E PARTISË SOCIALISTE

Kreu 3

ANËTARËSIA DHE RREGULLAT E ANËTARËSIMIT

Neni 15

E drejta e antarësisë

1. Antarësia në parti është vullnetare.
2. Antar i Partisë Socialiste mund të jetë çdo shtetas/e i Republikës së Shqipërisë pa dallim race, gjinie, gjuhe, kombësie, besimi fetar, etnie, gjendjeje ekonomike, pozite shoqërore, arsimimi, orientimi seksual dhe identiteti gjinor, aftësie të kufizuar që jeton brenda ose jashtë vendit, si dhe çdo shtetas i huaj me banim në Shqipëri, i cili:
 - a. Ka mbushur moshën 16 vjeç.

- b. Pranon Programin, Statutin dhe Kodin e Sjelljes.
 - c. Bën pjesë në një organizatë partie.
 - d. Nuk është antar i ndonjë partie tjetër politike, brenda ose jashtë vendit.
 - e. Pagan kuotën e antarësisë.
3. Antarët e partisë mund të nderohen për meritë të periudhës së gjatë të antarësisë dhe të kontributit të tyre në parti. Asambleja Kombëtare përcakton rregullat dhe modalitetet për nderimin e antarëve të partisë.

Neni 16

Pranimi në parti

1. Pranimi antar i partisë bëhet individualisht. Kandidati për antar partie plotëson formularin e antarësimit në parti. Data e dorëzimit të formularit është data e pranimit të tij në parti.
2. Antari i partisë pajiset me Kartën e antarësisë dhe Librezën vjetore.
3. Modalitetet për pajisjen me formular antarësimi, administrimi i tyre pas plotësimit, regjistrimi i antarit të partisë dhe hartimi i listave e regjistrave të antarësisë në proceset e zgjedhjeve në parti, për formën dhe sigurinë e dokumentave, mënyrën e ruajtjes, lëshimit dhe shpërndarjes së tyre dhe procedurat përkatëse përcaktohen në Librin e Rregullave.
4. Mbledhja, përpunimi, përdorimi i të dhënave personale për qëllime të ndryshme të partisë bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 17

Të drejtat e anëtarit të partisë

1. Antarët e partisë janë të barabartë në raport me partinë, pavarësisht funksioneve që kanë në parti dhe gjendjes ekonomike e pozicionit shoqëror jashtë saj.
2. Antari i partisë ka të drejtë:
 - a. Të marrë pjesë në veprimtarinë e partisë.
 - b. Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet drejtuese të partisë dhe të njihet me veprimtarinë e këtyre forumeve.
 - c. Të propozojë dhe/ose të propozohet kandidat përfaqësues i partisë në funksione publike të zgjedhura apo të emëruara dhe të njihet me veprimtarinë e përfaqësuesve të partisë në këto organe në përputhje me kriteret e përcaktuara në Statut apo Librin e Rregullave.
 - ç. Të jetë i pranishëm dhe të dëgjohet në organizatën e partisë kur diskutohen vërejtjet e propozimet që ka bërë dhe në mbledhjen e organeve drejtuese të partisë kur merret vendim mbi veprimtarinë e tij.
 - d. Të ankohet në organet drejtuese të partisë ose Komisionin e Garancive Statutore dhe Etikës kur shkelen të drejtat si dhe nuk është dakord me vendimin apo qëndrimin e mbajtur ndaj tij nga ana e strukturave të partisë.
 - dh. Të mbrohet nga partia kur ai diskriminohet ose përndiqet për bindjet e tij politike.
 - e. Të bëjë vlerësime për qeverisjen qendrore e vendore dhe të kërkojë informim të drejtpërdrejtë nga drejtuesit partiakë dhe nga përfaqësuesit e partisë në organet vendore e qendrore.
 - f. Të largohet nga partia me dëshirën e tij dhe pa detyrim për të dhënë shpjegime.

Neni 18

Detyrat e antarit të partisë

Antari i partisë ka për detyrë:

- a. Të bëjë pjesë në një organizatë partie.
- b. Të pajiset me kartën vjetore të antarësisë së partisë kundrejt shlyerjes së kuotës vjetore.
- c. Të zbatojë Programin, Statutin, Librin e Rregullave, Kodin e Etikës si dhe veprimtarinë politike të partisë.
- ç. Të pranojë mendimin ndryshe dhe të shprehë lirisht mendimet e veta në forumet e partisë.
- d. Të respektojë vendimin e shumicës, vendimet e organeve më të larta të partisë dhe t'i zbatojë ato.
- dh. Të respektojë disiplinën, normat shoqërore e të etikës në parti dhe të kontribuojë në forcimin e kohezionit të saj.
- e. Të punojë për rritjen e ndikimit të partisë në komunitet dhe shtimin e saj me anëtarë të rinj.
- ë. Të japë mendime e propozime për Programin, Statutin dhe programet elektorale të partisë.
- f. Të marrë pjesë dhe të kryejë detyra konkrete në fushatat zgjedhore për pushtetin vendor e qendror.
- g. Të parashtrijë në parti mendimet e propozimet e komunitetit për çdo çështje me interes të përbashkët.

Neni 19

Ndërprerja e përkohshme dhe e përhershme e anëtarësisë

1. Ndërprerja e antarësisë në parti mund të jetë e përkohshme ose e përhershme.
2. Ndërprerja e përkohshme e antarësisë bëhet kur antari i partisë:
 - a. Punësohet/zgjidhet në funksione në të cilët pjesëmarrja në parti politike ndalohej me ligj.
 - b. Nuk paiset me Librezën vjetore të antarësisë përkundrejt shlyerjes së kuotës për më shumë se një vit.Në këto raste OS bën heqjen e përkohshme nga lista të antarit të partisë. Nëse kushtet ndryshojnë, OS kryesisht me kërkesën e të interesuarit bën menjëherë përfshirjen e tij në listën e antarësisë.
3. Ndërprerja e përhershme e antarësisë bëhet kur antari i partisë:
 - a. Largohet me vullnetin dhe kërkesën e tij.
 - b. Dënohet nga organet gjyqësore me vendim penal të formës së prerë, me heqje lirie për kryerjen e një krimi
 - c. Ndërron jetë.
4. Në secilin rast antari i partisë çregjistrohet nga regjistri i antarësisë.

Neni 20

Përkrahësi i Partisë Socialiste

1. Përkrahësi i Partisë Socialiste është çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë si edhe çdo shtetas i huaj me banim në Shqipëri që pranon dhe mbështet programin dhe veprimtarinë politike të partisë.
2. Përkrahësi i Partisë Socialiste pajiset me kartën "Përkrahësi i PS". Kartën e përkrahësit të Partisë Socialiste e jep kryetari i partisë i bashkisë, sipas kërkesës së të interesuarit dhe rekomandimit të OS, FRESSH ose FGSSH.

Kreu 4

RREGULLAT DISIPLINORE TË PARTISË

Neni 21

Qëllimi i rregullave disiplinore

1. Disiplina në parti bazohet në njohjen dhe pranimin e mendimeve, diskutimeve alternative dhe të drejtave të anëtarëve të tjerë apo organeve drejtuese si dhe vendimeve të marra në përputhje me Statutin, Programin dhe Librin e Rregullave, mbështetur në parimin që pas procesit të diskutimeve, kryesjes së votimit dhe marrjes së vendimit, zbatohet dhe mbështetet vullneti i shumicës.
2. Rregullat disiplinore garantojnë që antarët, drejtuesit dhe organet e partisë të zbatojnë Statutin, Librin e Rregullave në funksion të realizimit të Programit dhe veprimtarisë politike të partisë.

Neni 22

Masat disiplinore

1. Masat disiplinore merren ndaj antarit të partisë, i cili/e cila shkel normat e Statutit dhe të Librit të rregullave dhe të Kodit të Etikës.
2. Masat disiplinore janë:
 - a. Vërejtje me shkrim.
 - b. Heqje e të drejtës së votimit në proceset zgjedhore në parti deri në një vit.
 - c. pezullim nga ushtrimi i funksioneve.
 - ç. Shkarkim nga organet e zgjedhura partiake.
 - d. Heqje e mbështetjes politike për mandatin e marrë.
 - dh. Përrjashtim dhe çregjistrim nga partia.
3. Vendimin për masë disiplinore ndaj antarit të partisë që ka kryer shkeljet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni e merr:
 - a. Organizata socialiste përkatëse.
 - b. Këshilli Socialist i njësisë administrative.
 - c. Asambleja Socialiste e bashkisë.
 - d. Komisioni i Garancive Statutore dhe Etikës.
 - e. Kryesia e partisë.
5. Rregulla më të hollësishme për masat disiplinore në parti, organet vendimarrëse, procedurat e ankimit dhe të shqyrtimit, përcaktimin e natyrës së shkeljeve konkrete, pezullimin nga detyra, administrimin e dokumentacionit, zbatimin e masave dhe të drejtën e shfuqizimit/revokimit si dhe periudhën e rehabilitimit përcaktohen në Librin e Rregullave.

PJESA E TRETË
RREGULLAT E ORGANIZIMIT TË PARTISË SOCIALISTE

Kreu 5

STRUKTURAT E PARTISË NË NIVEL VENDOR

1.1. ORGANIZATA SOCIALISTE (OS)

Neni 23

Organizata socialiste

1. Organizata socialiste është njësia bazë organizative dhe elektorale e partisë.
2. Organizata socialiste formohet:
 - a. Nga jo më pak se 10 anëtarë partie.
 - b. Në rastet kur nuk plotësohet numri i nevojshëm i antarëve të partisë për krijimin e organizatës socialiste, ngrihet grupi i antarëve të partisë.
3. Organizata socialiste ngrihet:
 - a. Sipas vendbanimit në bazë fshati, lagjeje ose grupi banesash në qytet, sipas parimit një organizatë socialiste për një qendër votimi.
 - b. Mbështetur në parimin jo më pak se 30% përfaqësim gjinor.
 - c. Mbi bazën e respektimit të parimeve të shmangjes së konfliktit të interesave dhe të shfaqjeve të nepotizmit.
4. Organizata socialiste mblidhet sipas problemeve që ka për shqyrtim ose atyre që i rekomandohen nga forumet më të larta të partisë. Organizata socialiste mblidhet me kërkesë të bashkëkryetarëve , 1/3 së antarëve, kryetarit të KS të njësisë administrative dhe kryetarit të partisë të bashkisë përkatëse.
5. Organizata socialiste mblidhet të paktën një herë në tre muaj.
6. Organizata socialiste e zhvillon mbledhjen zgjedhore, si rregull, pas çdo fushate për zgjedhjet e përgjithëshme dhe vendore, por në çdo rast duke respektuar një periudhë jo më të gjatë se dy vjet.
7. Veprimtaria e organizatës socialiste drejtohet nga dy bashkëkryetarë, një për secilën gjini, dhe sekretari/ët. Grupi i antarëve të partisë zgjedh një sekretar.
8. Pranë çdo organizate socialiste ngrihet e vepron grupi i të rinjve të FRESH dhe grupi i FGS.
9. Funkionimi dhe detyrat kryesore të organizatës socialiste, si dhe zgjedhja e kryetarëve dhe sekretarëve përcaktohen në Librin e Rregullave.

1.2. ORGANIZIMI I PARTISË NË NJËSINË ADMINISTRATIVE

Neni 24

Këshilli Socialist i Njësisë Administrative

1. Këshilli Socialist (KS) i njësisë administrative është strukturë koordinuese e organizimit dhe veprimtarisë së partisë në njësinë përkatëse administrative.
2. Këshilli Socialist i njësisë administrative përbëhet nga: Kryetari i Këshillit Socialist dhe kryetarët e OS të njësisë administrative, delegatët e Kongresit dhe këshilltarët e bashkisë banorë të asaj njësie antarë partie, administratori i njësisë administrative antar partie, kryetari i FRES dhe kryetare e FGS në njësinë administrative.

3 Këshilli Socialist i njësisë administrative, si rregull, mbledhet një herë në tre muaj, me kërkesë të kryetarit të Këshillit Socialist të njësisë administrative, të kryetarit të partisë të bashkisë dhe të të deleguarit të organeve qendrore të partisë.

4.Përbërja, kriteret dhe mënyra e zgjedhjes, si dhe funksionimi, detyrat e Këshillit dhe të Kryetarit të Këshillit Socialist, përcaktohen në Librin e Rregullave

1.3. ORGANIZIMI I PARTISË NË BASHKI

Neni 25

Asambleja Socialiste e bashkisë

1. Asambleja Socialiste e bashkisë është organi më i lartë vendimarrës i partisë në bashki.
2. Në përbërje të Asamblesë Socialiste të bashkisë bëjnë pjesë:
 - a. kryetari i partisë i bashkisë;
 - b.delegatët e Kongresit të Partisë të bashkisë;
 - c.kryetarët e këshillave socialiste të njësive administrative;
 - ç.deputetët socialistë të zonave elektorale të bashkisë;
 - d.kryetari i bashkisë antar partie;
 - dh.këshilltarët socialistë të bashkisë, antarë partie;
 - e.kryetari i FRES dhe kryetarja e FGS të bashkisë;
 - f. koordinatori/ët elektorale të zonave elektorale të bashkisë kur janë antarë partie.
- 3.Përbërja, kriteret dhe mënyra e zgjedhjes, si dhe funksionimi, detyrat e Asamblesë Socialiste të Bashkisë, përcaktohen në Librin e Rregullave
4. Organizimi i Asamblesë Socialiste të Bashkisë së Tiranës mbështetet dhe respekton rregullat e përgjithshme për organizimin dhe funksionimin e Asambleve Socialiste të bashkive, por rregullohet me një udhëzim të veçantë të Asamblesë Kombëtare të PS, që është pjesë e Librit të Rregullave

Neni 26

Kryetari i partisë i bashkisë

1. Kryetari i Partisë i bashkisë zgjidhet me votim nga mbledhja e zgjeruar e Asamblesë Socialiste të bashkisë.
6. Mandati i Kryetarit të partisë të bashkisë si rregull është katër vjet. Mandati i tij ndërpritet para kohe kur:
 - a.Jep dorëheqjen.
 - b.Shkarkohet nga Kryesia e Partisë për dobësi në punë e shkelje të normave të Statutit dhe të etikës.
 - c.Nuk fiton në mocionin e votëbesimit të zhvilluar për të.
 - ç.Humbet besimin e antarësisë dhe të organizatave socialiste të bashkisë dhe shkarkohet prej tyre.
 - d.Humbet në zgjedhjet vendore ose arrin rezultat më të dobët se zgjedhjet e mëparshme politike në bashkinë respektive.
- 7.Në rastet e mësipërme, mandati ndërpritet automatikisht dhe kryetari qëndron në detyrë deri në zgjedhjen e kryetarit të ri, jo më vonë se dy muaj pas ndërprerjes së mandatit

të kryetarit në detyrë. Në mungesë të kryetarit të partisë të bashkisë, detyrat e tij i kryen një nga sekretarët.

8. Kryetari i partisë i bashkisë është antar i AK, si përfaqësues i antarësisë së partisë të bashkisë përkatëse.

9. Kriteret, procedura e zgjedhjes dhe e shkarkimit, si dhe detyrat kryesore të Kryetarit të Partisë të Bashkisë, përcakton në Librin e Rregullave.

1.4. ORGANIZIMI I PARTISË NË RAJON DHE QARK

Neni 27

Organet e partisë në Rajon dhe Qark

1. Këshilli Koordinues i partisë në qark është struktura kryesore koordinuese e partisë në nivel qarku.
2. Këshilli Drejtues i partisë në rajon është struktura kryesore drejtuese e partisë në nivel rajoni.
6. Në Librin e Rregullave përcaktohet përbërja, juridiksioni, kompetencat, drejtimi dhe mënyra e funksionimit të këshillave në nivel rajoni dhe qarku.
7. Asambleja Kombëtare e PS mund të vendosë për struktura të tjera me funksione organizative dhe elektorale në nivel vendor.

Neni 28

Strukturat koordinuese elektorale

1. Në të gjitha nivelet e organizimit vendor të partisë, ngrihen strukturat koordinuese elektorale.
2. Ndërtimi, përzgjedhja, detyrat që kryejnë, funksionimi, varësia dhe modalitetet e bashkëpunimit të tyre me strukturat e forumet vendore të partisë përcaktohen në Librin e Rregullave.

1.5. ORGANIZIMI I PARTISË JASHTË VENDIT

Neni 29

Strukturat e partisë jashtë vendit

1. Për të siguruar pjesëmarrjen në jetën politike, sociale dhe kulturore të shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit, Partia organizon strukturat e veta në diasporë apo vendet pritëse të emigrantëve.
2. Strukturat e partisë në vendet pritëse të shqiptarëve gëzojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet si edhe strukturat e partisë në Shqipëri, të parashikuara në këtë Statut.
3. Organizatat socialiste në vendet pritëse të shqiptarëve ngrihen mbi bazë fshati, njësie administrative apo bashkie, nga janë apo vijnë emigrantët.
4. Kur nuk plotësohet numri i nevojshëm sipas kritereve më sipër, organizatat socialiste në vendet pritëse të shqiptarëve ngrihet edhe mbi bazën e territorit të vendit përkatës ku jetojnë emigrantët.

5. Për çdo qytet apo rajon në vendin ku jetojnë shqiptarë ngrihet Asambleja Socialiste e emigrantëve. Në përbërje të saj bëjnë pjesë kryetarët e organizatave socialiste të qytetit apo rajonit.
6. Asambleja Socialiste e qytetit apo rajonit zgjedh koordinatorin e saj.
7. Organi më i lartë i partisë jashtë vendit është Asambleja Socialiste e emigrantëve në vendin përkatës. Në përbërje të saj bëjnë pjesë koordinatorët e partisë të qyteteve dhe rajoneve të vendit përkatës.
8. Asambleja Socialiste e emigrantëve propozon kandidaturë për Kryekoordinator të partisë për vendin ku jetojnë emigrantët. Kryesia e Partisë zgjedh kryekoordinatorin e partisë për vendin ku jetojnë emigrantët.
9. Selia e Asamblesë Socialiste të shqiptarëve jashtë vendit si rregull, ndodhet në kryeqytetin e vendit ku jetojnë emigrantët.
10. Asambleja Socialiste e emigrantëve vendos e mban lidhje me çdo strukturë të saj në vendin ku vepron, me strukturat e partisë në bashkinë nga janë e vijnë emigrantët si dhe me strukturat e organizimit dhe emigracionit në selinë qendrore të PS.
13. Detyrat, përbërja, funksionimi dhe organizimi i strukturave të Partisë Socialiste jashtë vendit përcaktohen nga Asambleja Kombëtare në Librin e Rregullave .

Kreu 6

ORGANET DREJTUESE QENDRORE

Neni 30

Organet drejtuese e përfaqësuese të partisë në nivel qendror

1. Organet drejtuese e përfaqësuese të Partisë në nivel qendror janë:
 - a. Kongresi i Partisë
 - b. Asambleja Kombëtare e PS
 - c. Kryesia e PS
 - d. Kryetari i Partisë
2. Organet e tjera të përcaktuara në këtë Statut kanë funksione të veçanta ekzekutive administrative apo përfaqësim politik ose ligjor sipas përcaktimeve në këtë Statut apo në aktet e krijimit të tyre.

Neni 31

Kongresi i Partisë Socialiste

1. Kongresi është organi më i lartë vendimmarrës i partisë. Kongresi, përveç atij zgjedhor, si rregull, mbledhet një herë në vit. Mbledhja e Kongresit dhe rendi i ditës lajmërohen jo më vonë se 30 ditë më parë nga data e mbajtjes së tij. Data dhe rendi i ditës së Kongresit përcaktohen nga Asambleja Kombëtare.
2. Kongresi Zgjedhor mbledhet një herë në katër vjet kur përfundon mandatin e tij. Ai mund të mbledhet jashtë rradhe me kërkesë të Asamblesë Kombëtare, me kërkesë të jo më pak se 1/3 së delegatëve të Kongresit ose 1/3 së anëtarëve të partisë.
3. Kongresi i Jashtëzakonshëm thirret me vendim të Asamblesë Kombëtare, jo më vonë se një muaj nga data e marrjes së vendimit

Neni 32

Delegatët e Kongresit

1. Delegatët e Kongresit përbëhen nga delegatët e zgjedhur nga antarësia dhe delegatët *ex officio*. Numri i delegatëve të Kongresit të zgjedhur nga antarësia duhet të jetë më i madh se numri i delegatëve që janë të tillë për shkak të statusit të tyre (*ex officio*).
2. Delegatët e zgjedhur votohen nga antarësia e partisë, sipas parimit një antar një votë dhe bazuar në normën e përfaqësimit të miratuar nga Asambleja Kombëtare për çdo njësi administrative. Lista e kandidatëve për t'u votuar dhe lista e fituesve si delegatë duhet të sigurojë një përfaqësim të barabartë prej 50% për të dy gjinitë. Në çdo listë, 10 përqind e tyre janë të rinj dhe të reja të moshës deri 30 vjeç.
3. Delegatët e Kongresit *ex-officio* janë : Kryetari i partisë, antarët e partisë që kanë patur mandat të Kryetarit të partisë, të Presidentit të Republikës, të Kryeministrit, të Kryetarit të Kuvendit, deputetët dhe ministrat socialistë antarë partie, antarët e Asamblesë Kombëtare të PS që nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme, antarët e Komisionit të Garancisë Statutore dhe Etikës, antarët e Komisionit të Zgjedhjeve të partisë, kryetarët e partisë të bashkive, kryetarët e qarqeve e të bashkive antarë partie dhe prefektët antarë partie, kryetari i FRESSH dhe kryetarja e FGSSH.
4. Të drejtën e përfaqësimit me delegatë në Kongres e gëzojnë edhe strukturat e partisë jashtë atdheut si dhe sindikatat, shoqatat dhe komunitetet akademike me afërsi programore me partinë, sipas një norme përfaqësimi dhe kriterëve të miratuara nga Asambleja Kombëtare. Si rregull, delegatët nga organizatat sindikaliste, shoqatat dhe komunitetet akademike me afërsi programore me partinë duhet të përbëjnë rreth 10% të delegatëve të Kongresit të partisë. Normat për përfaqësimin gjinor zbatohen edhe nga strukturat e partisë jashtë vendit si edhe nga sindikatat, shoqatat dhe komunitetet akademike.
5. Delegatë të zgjedhur mund të jenë antarët e partisë, të cilët:
 - a. Plotësojnë të gjitha kushtet e antarësimit, të përshkruara në nenin 16.
 - b. Janë banorë në territorin e organizatës së partisë ku zgjidhen.
 - c. Janë antarë të partisë prej jo më pak se 12 muaj para datës së zgjedhjes.
 - ç. Nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë të organeve gjyqësore me heqje të lirisë.
6. Mandati i delegatit të Kongresit është katër vjet. Mandati i delegatit ndërpritet para kohe kur jep dorëheqjen, çrregjistrohet ose largohet nga partia. Mandati i filluar si delegat kongresi për antarët e Asamblesë Kombëtare vazhdon deri në Kongresin zgjedhor të rradhës.
7. Në Kongresin e partisë marrin pjesë si të ftuar deputetët, ministrat, kryetarët e këshillave të qarqeve, prefektët, kryetarët e bashkive, kryetarët e këshillave të bashkive përfaqësues të partisë jo antarë partie.

Neni 33

Kompetencat e Kongresit të partisë

1. Kongresi miraton Programin dhe Statutin e partisë dhe bën ndryshime e përmirësime në to si dhe miraton rezoluta e dokumenta të tjera që çmohen prej tij.
2. Kongresi analizon veprimtarinë e partisë gjatë periudhës ndërmjet dy kongreseve dhe përcakton objektivat kryesore për të ardhmen.
3. Kompetencat e Kongresit për zgjedhjen e Kryetarit të Partisë:

- a. Përfaqësia e Kongresit administron kandidaturat për Kryetar të partisë, shoqëruar me kërkesat për kandidim dhe platformat për drejtimin e partisë të paraqitura prej tyre.
 - b. Kandidatët për Kryetar të partisë paraqesin në Kongres platformat e tyre.
 - c. Kongresi vendos datën e zhvillimit të votimit nga antarësia e partisë në shkallë vendi për zgjedhjen e Kryetarit të partisë sipas parimit një antar një votë, jo më vonë se 30 ditë nga data e zhvillimit të Kongresit.
4. Kompetencat e Kongresit për zgjedhjen e Asamblesë Kombëtare dhe Komisionit të Garancive Statutore dhe Etikës:
- a. Përfaqësia i paraqet Kongresit për miratim listën me kandidaturat për antarë të Asamblesë Kombëtare sipas qarqeve, listën me kandidaturat për Komisionin e Garancive Statutore dhe Etikës (KGSE).
 - b. Kongresi zgjedh me votim të fshehtë dhe kandidatura alternative Asamblesë Kombëtare dhe Komisionin e Garancive Statutore dhe Etikës. Votimi për kandidaturat shoqe për antarë të Asamblesë Kombëtare bëhet me listë të veçantë. Shoqet përbëjnë jo më pak se 50 përqind të listës së kandidaturave për antarë të Asamblesë Kombëtare.
 - c. Numri i antarëve të Asamblesë Kombëtare të zgjedhur nga Kongresi duhet të jetë më i madh se numri i antarëve të Asamblesë Kombëtare që janë të tillë për shkak të statusit të tyre.
5. Përfaqësia është organ i Kongresit që merret me administrimin e mbarëvajtjes së Kongresit. Ajo përbëhet nga delegatët të Kongresit të zgjedhur nga delegatët e qarqeve dhe drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm. Përfaqësia mblidhet të paktën një javë para Kongresit për përcaktimin e procedurës së punës së Kongresit, drejtimin e punimeve të tij, procedurën e paraqitjes së dokumentave dhe kandidaturave që do t'i paraqiten Kongresit, organizimin e punës për paraqitjen dhe votimin e kandidaturave për forumet drejtuese etj. Përfaqësia mblidhet gjatë punimeve të Kongresit sa herë që çmohet e nevojshme për funksionimin e punimeve të Kongresit. Asambleja Kombëtare miraton normën përkatëse për zgjedhjen e përfaqësisë nga delegatët e qarqeve, numrin e kandidaturave për antarë të Asamblesë Kombëtare për çdo qark si dhe rregulloren e punës së përfaqësisë.
7. Votimi prej delegatëve të Kongresit i raporteve, rezolutave dhe dokumenteve të tjera bëhet i hapur, duke ngritur dorën ose duke ngritur mandatin. Votimi i zgjedhjes së forumeve drejtuese të partisë bëhet i fshehtë dhe me kandidatura alternative.

Neni 34

Kryetari i Partisë Socialiste

1. Kryetari i Partisë Socialiste është drejtuesi më i lartë politik i partisë.
2. Kryetari i Partisë Socialiste ka këto kompetenca kryesore:
 - a. Është përgjegjës kryesor për drejtimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë së përditshme të partisë në zbatim të Programit, të linjës politike të miratuar nga Kongresi dhe forumet drejtuese të partisë, të Statutit dhe të rregulloreve.
 - b. Përfaqëson partinë në marrëdhëniet me partitë e tjera, me organizatat, shoqatat dhe institucionet brenda e jashtë vendit.

- c. Propozon në Kryesinë e partisë masa të veçanta në zbatim të Programit dhe Statutit të partisë.
- ç. Thërret dhe drejton mbledhjen e Kryesisë së partisë.
- d. Drejton dhe bashkërendon punën e Sekretariatit Ekzekutiv të partisë.
- e. Propozon kandidatët për Kryetar të Grupit Parlamentar Socialist, për kryetar e nënkryetar të Kuvendit, për kryetarë të komisioneve si edhe të delegacioneve të përhershme të Kuvendit të Shqipërisë dhe ia paraqet për votim Grupit Parlamentar Socialist. Kandidati për kryetar të GPS dhe Kryetar Kuvendi duhet të jenë antarë të Kryesisë së PS
- f. Ka të drejtën e kërkesës për rishqyrtim të vendimeve të Kryesisë së partisë në Asamblenë Kombëtare, kur e gjykon të nevojshme. Kërkesa miratohet në Asamblenë Kombëtare me shumicë të thjeshtë të votave të pjesëmarrësve në votim.
- g. Drejton procesin për hartimin, miratimin dhe paraqitjen e listave të kandidatëve të partisë në zgjedhjet legislative e vendore në përputhje me rregullat e miratuara nga Asambleja Kombëtare.

Neni 35

Zgjedhja e Kryetarit të partisë

1. Kryetari i partisë zgjidhet nga antarësia e partisë sipas parimit një antar një votë. Zgjedhja e Kryetarit të partisë, bëhet me votim individual, të drejtëpërdrejt dhe të fshehtë. Asambleja Kombëtare i shpall zgjedhjet e reja jo më vonë se tre muaj para përfundimit të mandatit të Kryetarit në detyrë.
2. Kandidatët për Kryetar të partisë duhet të kenë të paktën një mandat si antar të Asamblesë Kombëtare ose të jenë mbi pesë vjet antar të partisë. Prezantimi i kandidaturës së Kryetarit të partisë duhet të ketë mbështetjen e 10% të delegatëve të Kongresit ose 5% të antarësisë së partisë. Asnjë prej tyre nuk duhet të ketë mbështetjen e më shumë se 20% të delegatëve/antarëve.
3. Mandati i Kryetarit të partisë është katër vjet. Mandati i tij ndërpritet para kohe kur:
 - a. Jep dorëheqjen.
 - b. Partia humbet vendin e parë në zgjedhjet e përgjithshme.
 - c. Humbet në mocionin e mosbesimit të zhvilluar për të me kërkesën e 1/3 së antarëve të partisë.

Në rastet e gjurmës “b” Kryetari i partisë është i detyruar të japë dorëheqjen. Në rast se kjo nuk ndodh, ndërprerja e mandatit ndodh automatikisht dhe Asambleja Kombëtare fillon procedurat e zgjedhjes së Kryetarit të ri të partisë jo më vonë se një muaj nga ndërprerja e mandatit të Kryetarit.

Në rast të pikave “b”, “c” dhe ish Kryetari i partisë nuk ka të drejtë të rikandidojë për një mandat të ri.

Kur vendi i Kryetarit të partisë mbetet vakant, brenda 30 ditëve thirret Kongresi i Jashtëzakonshëm i partisë.

4. Kryetari i partisë në kongresin elektoral para zgjedhjeve të përgjithshme përcaktohet si kandidati zyrtar i partisë për detyrën e Kryeministrit të vendit.

Në rastin kur Kryetari i partisë tërhiqet vullnetarisht nga kandidimi për Kryeministër ose nga funksioni i Kryeministrit, Asambleja Kombëtare miraton në këtë detyrë një përfaqësues tjetër që plotëson kriteret përkatëse.

5. Kur partia është në qeveri dhe Kryetari i saj zgjidhet Kryeministër, mandati i kryetarit konsiderohet i rinovuar automatikisht. Zgjedhjet për Kryetarin e partisë do të zhvillohen vetëm nëse kërkohet nga të paktën 10% e delegatëve dhe kërkesa merr mbështetjen e shumicës së delegatëve të kongresit në votimin që zhvillohet në Kongresin vjetor të partisë.

6. Kur krijohet vakanca në funksionin e Kryetarit të partisë, kompetencat e tij përkohësisht ushtrohen nga Sekretari i Përgjithshëm deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri. Në çdo rast zgjedhja e Kryetarit të ri bëhet jo më vonë se dy muaj nga vakanca e krijuar.

Neni 36

Asambleja Kombëtare e partisë, përbërja, drejtimi

1. Asambleja Kombëtare përbëhet nga antarët e zgjedhur me votim nga Kongresi, antarët që janë drejtpërdrejt në përbërje të saj për shkak të statusit të tyre (*ex-officio*) dhe nga antarët e zgjedhur si përfaqësues të sindikatave, shoqatave dhe komuniteteve akademike me afërsi programore me PS. Antarët e zgjedhur si përfaqësues të sindikatave, shoqatave dhe komuniteteve akademike, si rregull, duhet të përbëjnë 10% të antarëve të Asamblesë Kombëtare. Numri i antarëve të Asamblesë Kombëtare të zgjedhur nga Kongresi në çdo rast duhet të jetë më i madh se numri i antarëve *ex-officio*.

2. Antarë *ex-officio* të Asamblesë Kombëtare të partisë janë: Kryetari i partisë, deputetët dhe ministrat antarë partie, kryetarët e partisë së bashkive, kryetarët e bashkive anëtar partie, kryetarët e këshillave të qarqeve anëtar partie, Kryetari i FRESSH dhe Kryetarja e FGSSH si dhe antarët e partisë që kanë patur mandat të Kryetarit të partisë, Presidentit të Republikës, Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit.

3. Antarët e zgjedhur të Asamblesë Kombëtare zgjidhen prej Kongresit të Partisë me kandidatura alternative dhe votim të fshehtë e individual.

Kandidaturat për antarët e zgjedhur të Asamblesë Kombëtare propozohen nga delegatët e qarqeve respektive sipas normës së përfaqësimit në bazë qarku dhe në përputhje me kriteret e vendimit të miratuar nga Asambleja Kombëtare. Përfaqësia e Kongresit bën vlerësimin e plotësimin të kushteve dhe kriterëve të meritës për kandidatët dhe përcakton listën përkatëse alfabetike të çdo qarku. Kryesia ka të drejtën të bëjë propozime të reja shtesë, por në çdo rast jo më shumë se 10% të listave respektive të qarqeve.

Numri i antarëve të Asamblesë Kombëtare që zgjidhen nga Kongresi duhet të jetë jo më pak se 51% e numrit të përgjithshëm të Asamblesë Kombëtare.

Votimi për antarët e Asamblesë Kombëtare bëhet në bazë qarku për listat e kandidatëve të qarkut përkatës.

Lista e kandidatëve për t'u votuar dhe lista fituese për Asamblenë Kombëtare duhet të sigurojë një përfaqësim jo më pak se 40% të secilës gjini. Votimi për çdo gjini bëhet me listë të veçantë. Lista e kandidatëve të çdo qarku për t'u votuar për Asamblenë Kombëtare duhet të sigurojë një përfaqësim jo më pak se 10% për antarët e FRESSH.

4. Antar i Asamblesë Kombëtare mund të jetë antari i partisë, i cili plotëson kushtet e mëposhtëme: a) të ketë si rregull jo më pak se tre vjet si antar partie; b) të ketë një veprimtari të spikatur politike në rradhët e partisë ose të jetë një personalitet i njohur në fushën e veprimtarisë shoqërore dhe profesionale; c) të plotësojë kushtet e integritetit moral e ligjor sipas kërkesave të nenit 45 të këtij Statuti; d) të mos jetë nënpunës i shërbimit civil.

5. Asambleja Kombëtare mblidhet jo më rrallë se një herë në katër muaj. Mbledhja e Asamblesë Kombëtare thirret nga Sekretari i Përgjithshëm, sipas axhendës vjetore politike të miratuar nga Asambleja Kombëtare ose edhe me kërkesë të Kryesisë, të Kryetarit të partisë, ose të jo më pak se 1/3 së antarëve të saj. Nëse nuk mblidhet të paktën dy herë rresht në afatin e mësipërm, Asambleja Kombëtare shpërndahet automatikisht. Kryetari i partisë thërret Kongresin e Jashtëzakonshëm për të zgjedhur Asamblenë e re.

Në mbledhjen e Asamblesë Kombëtare kanë të drejtë të marrin pjesë deputetët e ministrat socialistë jo antarë partie, Kryetari i KGSE, Kryetari i KZP, Kryefinancieri dhe Kryetari i Komisionit të Mbikqyrjes Financiare.

6. Nëse në periudhën mes dy Kongreseve antari i Asamblesë Kombëtare zgjidhet/emërohet në funksione që bien ndesh me antarësinë në këtë organ ose për shkak të arsyeve të tjera nuk mund të mbajë postin e tij, Asambleja Kombëtare në vend të tij mund të propozojë antarin me numër më të madh të votave në listën e kandidatëve për Asamblenë Kombëtare. Me propozim të Kryesisë së partisë, Asambleja Kombëtare ka të drejtën e kooptimit të antarëve të rinj, deri në 5 % të numrit të antarëve, nëse në përbërje të saj ka ose krijohen mungesa si dhe për arsye të tjera të argumentuara, por pa kaluar numërin e antarëve të zgjedhur.

7. Selia e Asamblesë Kombëtare është në Tiranë.

Neni 37

Detyrat e Asamblesë Kombëtare të partisë

Asambleja Kombëtare, midis dy Kongreseve të partisë, ushtron këto detyra:

- a. Organizon dhe drejton punën dhe veprimtarinë politike, organizative, elektorale dhe propagandistike të partisë gjatë periudhës midis dy kongreseve.
- b. Shqyrton dhe miraton dokumentat për qëndrimet politike për gjendjen në vend, qeverisjen dhe situatën ndërkombëtare.
- c. Miraton programin elektoral të partisë, projektet për ndryshimet në Statutin e partisë dhe axhendën politike, organizative dhe elektorale të partisë.
- ç. Miraton aleancat me forcat e tjera politike që kanë afërsi programore në zgjedhjet e përgjithshme dhe për qeverisjen vendore.
- d. Zgjedh Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë, Kryesinë, Sekretariatin Ekzekutiv, Komisionin e Zgjedhjeve të Partisë, Kryefinancierin si dhe Këshillin e Mbikqyrjes Financiare. Proçedurat e votimit të forumeve drejtuese që zgjedh Asambleja Kombëtare përcaktohen me vendim të veçantë të saj.
- dh. Vendors për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve të përgjithshme e të zgjedhjeve vendore në parti. Rregullat dhe proçedurat e zgjedhjeve në strukturat e partisë, proçedurat e votimit, ngritja dhe funksionimi i organizmave për përgatitjen dhe administrimin e zgjedhjeve përcaktohen në Kodin e Zgjedhjeve që miratohet prej saj.
- e. Asambleja Kombëtare miraton Librin e Rregullave të Partisë me rregullore, udhëzime, kriteret dhe norma lidhur me organizimin, regjistrin, drejtimin dhe funksionimin e

- strukturave drejtuese të partisë në njësi administrative, bashki, qark dhe në nivel qendror, administrimin e veprimtarisë së partisë në nivel qendror e vendor, organigramën dhe strukturën e stafit administrativ të saj, të institucioneve të tjera qendrore dhe vendore, krijimin dhe administrimin e burimeve financiare, infrastrukturës dhe mjeteve logjistike për ushtrimin e veprimtarisë së organeve drejtuese të partisë në të gjitha nivelet dhe detyra të tjera të deleguara nga ky Statut.
- ë. Vendos për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturave elektorale në bazë territori në përputhje me funksionet elektorale.
 - f. Krijon komisione të përhershme dhe të përkohshme pune për të studiuar e zgjidhur probleme teorike, politike e organizative, të cilat, si rregull, ngrihen mbi bazën e komisioneve parlamentare.
 - g. Asambleja Kombëtare i zhvillon punimet dhe funksionon në bazë të Rregullores, e cila miratohet me shumicë të cilësuar prej saj.
 - gj. Asambleja Kombëtare thërret mbledhjen e Aktivit Kombëtar të partisë për tematika të caktuara të miratuara prej saj.

Neni 38

Kryesia e Partisë Socialiste, përbërja, drejtimi, funksionimi

1. Kryesia e Partisë është organi politik drejtues i veprimtarisë së partisë.
2. Kryesia organizon dhe drejton veprimtarinë e partisë në periudhën midis mbledhjeve të Asamblesë Kombëtare.
3. Kryesia e partisë përbëhet nga Kryetari i partisë, Sekretari i Përgjithshëm, Sekretarët dhe antarët e Kryesisë të zgjedhur nga rradhët e antarëve të Asamblesë Kombëtare. Numri i antarëve të Kryesisë miratohet nga Asambleja Kombëtare me propozim të Kryetarit të partisë.
4. Kriteret, mënyra e zgjedhjes, detyrat kryesore dhe funksionimi i Kryesisë, përcaktohen në Librin e rregullave.

Neni 39

Sekretari i Përgjithshëm i partisë

1. Sekretari i Përgjithshëm zgjidhet nga rradhët e Asamblesë Kombëtare dhe është përgjegjësi kryesor për drejtimin dhe funksionimin organizativ të partisë.
2. Sekretari i Përgjithshëm ka këto detyra kryesore:
 - a. Drejton mbledhjet e Asamblesë Kombëtare.
 - b. Koordinon Sekretariatit Ekzekutiv.
 - c. Në mungesë dhe me porosi të Kryetarit të partisë, drejton mbledhjet e Kryesisë së partisë.
 - ç. Ndjek dhe përgjigjet për zbatimin e Statutit, vendimeve të miratuara nga Kongresi dhe rregulloreve e udhëzimeve të forumeve drejtuese të partisë.
 - d. I propozon Asamblesë Kombëtare për shqyrtim e miratim dokumentat për projekt-statutet, projekt-aktet e ndryshme, pjesë të Librit të Rregullave të partisë.
 - dh. Ndihmon dhe kontrollon organet drejtuese të strukturave vendore të partisë për zbatimin e vendimeve të organeve qendrore të partisë si dhe miraton programet e trajnimeve dhe aftësimin e të zgjedhurve në to.

- e. Parashtron kërkesën për pezullimin e vendimeve të Asamblesë Socialiste të bashkisë, kur ato bien ndesh me Statutin dhe Programin e partisë.
 - ë. Propozon organigramën dhe strukturën e administratës së Asamblesë Kombëtare, të institucioneve të tjera qendrore të partisë dhe të Asambleve Socialiste të bashkive.
 - f. Kryen funksionet e Kryetarit të partisë për periudhën kur vendi i tij mbetet vakant.
3. Kandidati për Sekretar të Përgjithshëm të Partisë propozohen nga Kryetari i Partisë, ndërsa kandidatët alternativë duhet të sigurojnë mbështetjen e 10% të anëtarëve të Asamblesë Kombëtare.
4. Mandati i Sekretarit të Përgjithshëm të partisë është 4 vjet. Mandati i tij ndërpritet para kohe kur:
- a. Jep dorëheqjen.
 - b. Humbet në mocionin e mosbesimit të zhvilluar për të me kërkesën e 1/3 së antarëve të AK.
 - c. Nuk plotëson kushtetet e integritetit moral e ligjor sipas kërkesave të nenit 52 të këtij Statuti.
5. Funksioni i Sekretarit të Përgjithshëm është i papajtueshëm me funksionin e antarit të kabinetit qeveritar si dhe me çdo lloj funksioni tjetër ekzekutiv me kohë të plotë.

Neni 40

Sekretariati Ekzekutiv i partisë

1. Sekretariati Ekzekutiv është organ politik i partisë me funksione ekzekutive. Sekretariati ekzekutiv drejton vepritarinë e përditshme të partisë sipas tematikave dhe sektorëve që sekretarët mbulojnë.
2. Funksioni i Sekretarit të partisë është i papajtueshëm me funksionin e antarit të kabinetit qeveritar si dhe me çdo lloj funksioni tjetër ekzekutiv me kohë të plotë.
3. Asambleja Kombëtare miraton, me propozim të Kryetarit të partisë, numrin dhe strukturën e Sekretariatit Ekzekutiv të partisë. Kriteret, detyrat dhe kompetencat e Sekretariatit Ekzekutiv përcaktohen në Librin e Rregullave.
4. Në mbështetje të punës së Sekretarëve funksionojnë nënsekretarët jofunksionarë, përzgjedhja e të cilëve bëhet nga Kryesia e partisë, si rregull nga rradhët e prurjeve të reja në forumet e partisë. Kryesia e Partisë miraton numrin, kriteret, mënyrën e funksionimit dhe detyrat që mbulojnë nënsekretarët.

Neni 41

Komisioni i Garancive Statutore dhe Etikës (KGSE)

1. Komisioni i Garancive Statutore dhe Etikës (KGSE) vendos për çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin dhe interpretimin e Statutit, të vendimeve dhe rregulloreve të forumeve qendrore të partisë si dhe Kodin e Etikës, duke ofruar mendime dhe shpjegime në dispozitat e tyre apo ndërhyrë në çështjet që mund të lindin.
2. KGSE përbëhet nga 5 antarë. Antarët e partisë kandidatë për t'u zgjedhur në KGSE në momentin e zgjedhjes duhet të kenë të paktën 10 vjet antarësi në parti. Antarët e KGSE nuk mund të jenë antarë të organeve të tjera qendrore të partisë dhe as punonjës të administratës të partisë.
3. Mandati i KGSE zgjat katër vjet.

4. KGSE vihet në lëvizje mbi bazën e ankesave dhe kërkesave të antarëve, strukturave e organeve të parties, ose kryesisht. Mbledhja e KGSE është e vlefshme kur në të marrin pjesë 2/3 e anëtarëve të tij. Vendimet e KGSE merren me votim të hapur, me shumicë të thjeshtë votash dhe janë të detyrueshme për t'u zbatuar.
5. KGSE nuk mund të shqyrtojë e të gjykojë vendimet e Kongresit dhe vendimet politike të Asamblesë Kombëtare.
6. Rregullat e ngritjes dhe të funksionimit të KGSE përcaktohen me rregullore të veçantë që propozohet nga KGSE dhe miratohet nga Asambleja Kombëtare.
7. KGSE harton një raport vjetor mbi zbatimin e Kodit të Etikës dhe kur është e nevojshme, paraqet në Asamblesë Kombëtare propozimet për ndryshimin ose plotësimin e Kodit të Etikës.

Neni 42

Komisioni i Zgjedhjeve i Partisë (KZP)

1. Komisioni i Zgjedhjeve i Partisë (KZP) është struktura qendrore përgjegjëse për përgatitjen, organizimin dhe mbikqyrjen e zgjedhjeve sipas parimit një antar një votë.
2. Në nivel bashkie, ngrihet Komisioni i Zgjedhjeve i Partisë i Bashkisë (KZPB). Për çdo njësi administrative ngrihet KZPNJA-ja, ndërsa kur njësi administrative ka më shumë se një vendvotim, ngrihet Komisioni i Vendvotimit (KVV).
3. KZP përbëhet nga 7 antarë, KZPB përbëhet nga 5 antarë, kurse KZPNJA e KVV përbëhen nga 3 antarë.
4. Mandati i antarit të KZP është katër vjet.
5. Funksionimi dhe kompetencat e KZP dhe të komisioneve zgjedhore vendore përcaktohen në Kodin e Zgjedhjeve në parti, pjesë e Librit të rregullave.

PJESA E KATËRT

PËRFAQËSUESIT E PARTISË NË DEGËT E QEVERISJES

Kreu 7

RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 43

Përfaqësimi

1. Partia Socialiste përfaqësohet në organet e pushtetit shtetëror nga të zgjedhurit e saj në Kuvendin e Shqipërisë dhe në organet e qeverisjes qendrore e vendore.
2. Parimet, kriteret, raportet gjinore dhe procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për përfaqësimin politik përcaktohen në këtë Statut dhe në Librin e Rregullave, sipas zgjedhjeve për organet respektive.
3. Çdo antar partie, që ka jo më pak se një vit i antarësuar përfiton nga e drejta për tu qenë kandidat i partisë për funksione publike në pushtetin/organet legjislativë dhe ekzekutive të qeverisjes, në nivel qendror dhe vendor.
4. Të gjithë antarët e partisë kanë të drejta të barabarta për t'u zgjedhur ose emëruar për të ushtruar funksione publike, por partia mbështet në mënyrë prioritare antarët e saj më të kualifikuar si edhe përfaqësuesit nga gjinitë dhe komunitetet më pak të përfaqësuara.

5. Proçedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për funksione publike legislative dhe ekzekutive të qeverisjes vendore e qendrore duhet të jenë transparente, të thjeshta dhe lehtësisht të administrueshme.

Neni 44

Parimet e zgjedhjes së përfaqësuesve të partisë në organet e qeverisjes

Kandidatët e partisë për përfaqësues në organet e qeverisjes qendrore e vendore zgjidhen sipas parimeve të mëposhtme:

- a. Përparësisë së meritës për zgjedhjen e kandidatëve më të aftë profesionalisht dhe me integritet të lartë publik.
- b. Kontributi dhe përfaqësimi i kandidatëve në shoqëri, politikë dhe territor.
- c. Barazia midis burrave dhe grave.
- d. Shmangia e mbajtjes së disa funksioneve e përgjegjësiwe njëkohësisht.
- e. Ndërthurja e përfaqësimit të brezave të ndryshëm dhe përfaqësimi i denjë i të rinjve dhe të rejave.
- f. Kufizimi në kohë i mbajtjes së mandateve të përfaqësimit nga i njëjti person.
- g. Barazia e të gjithë antarëve dhe për të gjithë votuesit.
- h. Transparenca e procedurës së përzgjedhjes.

Neni 45

Integriteti dhe standartet në përzgjedhjen e kandidatëve

1. Përfaqësuesit e partisë në funksione politike në pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv të qeverisjes qendrore e vendore duhet të karakterizohen nga standartet më të larta të integritetit dhe të garantojnë besimin e publikut tek organet e zgjedhura shtetërore, institucionet dhe administratën publike të shtetit të së drejtës.
2. Para kandidimit ose emërimit në funksionin politik, kandidatët e propozuar për t'u zgjedhur ose emëruar plotësojnë një formular/deklaratë, të miratuar nga Asambleja Kombëtare, bazuar në legjislacionin shqiptar për integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, bëjnë transparente të kaluarën e tyre si dhe shprehin angazhimin se, nëse zgjidhen ose emërohen, do të zbatojnë me korrektesë standartet e funksioneve për të cilat kandidojnë ose emërohen si edhe rregullat dhe orientimet e partisë.
3. Deklarimi i pasaktë apo i rremë në formular/deklaratë është përgjegjësi personale penale dhe politike. Pavarësisht nëse përbën vepër penale, ndaj deklaruesit të pasaktë apo të rreme merret masa disiplinore e ç'rregjistrimit të përhershëm nga partia.

Neni 46

Kodi i Etikës

1. Partia ka Kodin e Etikës, në të cilin përmbliohen kriteret e komunikimit dhe marrëdhëniet e etike brenda rradhëve të partisë dhe në komunikimin me zgjedhësit, standartet e integritetit moral dhe etik që duhet të përmbushë çdo kandidat gjatë ushtrimit të mandatit të tij si

përfaqësues i Partisë Socialiste për organet qendrore e vendore të partisë dhe ato të qeverisjes.

2. Kodi përcakton edhe formularët që duhet të përmbush çdo kandidat para paraqitjes së kandidaturës së tij, masat konkrete për shkëljen e këtij Kodi si dhe procedurat përkatëse për to.

3. Personat që përjashtohen në bazë të Kodit të Etikës nuk mund të jenë kandidatë për funksionet e ndryshme partiake ose të emërohen nga partia për çdo lloj detyre që ka mbështetjen politike të partisë.

4. Kodi i etikës miratohet nga Asamble Kombëtare dhe është pjesë e Librit të Rregullave

Neni 47

Marrëdhëniet me organet e qeverisjes qendrore e vendore

1. Partia Socialiste e zhvillon politikën e saj në degët e qeverisjes qendrore e vendore nëpërmjet përfaqësuesve të saj të zgjedhur në institucionet përkatëse qeverisëse.

2. Organizatat dhe organet drejtuese të partisë bëjnë vlerësim për veprimtarinë e përfaqësuesve të partisë në degët e qeverisjes, sa herë që konsiderohet e nevojshme.

3. Përfshirja e grave dhe vajzave në listat shumëemërore për deputetë dhe për antarë të këshillave të bashkive respekton detyrimin e parashikuar në Kodin Zgjedhor.

4. Parimet, kriteret, procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve dhe marrëdhëniet me përfaqësuesit e partisë në degët e qeverisjes përcaktohen nga Asambleja Kombëtare e partisë, në përputhje me kërkesat ligjore për zgjedhjen dhe funksionimin e degëve të qeverisjes.

Neni 48

Papajtueshmëria me detyrën e kryetarit të partisë në nivel vendor

Ministrat, deputetët, kryetari i bashkisë dhe prefekti, gjatë ushtrimit të mandatit të tyre nuk mund të jenë kandidatë ose të zgjedhur në detyrën kryetarit të partisë të bashkisë dhe në funksione të tjera të caktuara në rregulloren përkatëse të Asamblesë Kombëtare. Kryesia e partisë mund të bëjë përjashtim për deputetët, për periudha të përkohshme dhe raste të vecanta.

Kreu 8

PËRFAQËSUESIT E PARTISË NË DEGËT E QEVERISJES

Neni 49

Grupi parlamentar socialist

1. Deputetët socialistë, të zgjedhur në Kuvend përbëjnë Grupin parlamentar të Partisë Socialiste (GPPS).

2. Grupi parlamentar është strukturë politike e partisë që zbaton programin dhe politikën e saj në veprimtarinë parlamentare. Organet më të larta të partisë informohen dhe analizojnë këtë veprimtari. Grupi drejtohet nga Kryetari dhe Kryesia e Grupit. Kandidati për kryetar të GPS duhet të jetë anëtar i Kryesisë së PS

3. Veprimtaria konkrete, të drejtat dhe detyrat e antarëve, shkalla e autonomisë në vendimmarrje, marrëdhëniet midis Grupit parlamentar dhe partisë përcaktohen në rregullore të veçantë të propozuar nga GPS dhe të miratuar nga Asambleja Kombëtare.

Neni 50

Përfaqësuesit e partisë në strukturat drejtuese të Kuvendit

1. Pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve parlamentare, Grupi parlamentar i partisë i paraqet Kuvendit kandidatët e partisë për kryetar ose/dhe zëvendëskryetar të Kuvendit, kryetarë dhe zëvendëskryetarë të komisioneve parlamentare dhe për delegacionet e përhershme parlamentare. Kandidati për Kryetar Kuvendi duhet të jetë anëtar i Kryesisë së partisë.
2. Përfaqësuesit e partisë në funksionet kryetar dhe zëvendëskryetar i Kuvendit si dhe për kryetarë dhe zëvendëskryetarë të komisioneve parlamentare mbajnë marrëdhënie të vazhdueshme dhe bashkëpunojnë me Grupin parlamentar socialist, Kryesinë e tij, Asamblenë Kombëtare, Kryesinë, Sekretarin e Përgjithshëm dhe Sekretariatit Ekzekutiv si edhe me antarët e partisë dhe zgjedhësit.

Neni 51

Zgjedhja e kandidatëve për deputetë

1. Përpara çdo fushate për zgjedhje të përgjithëshme, Kryesia, i paraqet për miratim Asamblesë Kombëtare kriteret dhe rregullat e procesit për përzgjedhjen dhe konsultimin e kandidatëve për deputetë. Lista e zgjeruar e propozimeve së bashku me rekomandimet përkatëse administrohet nga Kryesia. Lista përfundimtare e kandidatëve për deputetë miratohet nga Kryesia e PS.
2. Kryesia e Grupit parlamentar socialist, në mbyllje të legjislaturës, në rastet kur deputetët përfshihen në listën e rikandidimit, harton një vlerësim individual lidhur me performancën e deputetit gjatë mandatit, lidhur me marrëdhëniet e mbajtura me zonën përkatëse elektorale, përfaqësimin në komisione, në mbledhje grupi dhe në seancë plenare, inisiativat ligjore të ndërmarra, paraqitjen publike dhe kriteret të tjera të përcaktuara nga rregullorja e Grupit parlamentar socialist.
3. Para kandidimit si deputet, kandidatët e propozuar nënshkruajnë një deklaratë, në të cilën vërtetojnë përbushjen e integritetit ligjor e moral si dhe angazhimin se, nëse zgjidhen, do të zbatojnë me korrektesë rregullat e funksionimit të Grupit parlamentar socialist.

Neni 52

Përfaqësuesit e partisë në degën ekzekutive të qeverisjes

1. Kur partia është në qeverisje të vendit, Kryesia e Partisë dhe Grupi Parlamentar informohen e japin pëlqim për kandidaturat për përfaqësuesit si ministra, zv/ministra dhe funksionarët e tjerë të lartë publikë politikë.
2. Kriteret që duhet të përbushin kandidatët për përfaqësues të partisë në qeveri dhe funksionarë të tjerë publikë politikë janë të njëjta me kërkesat që duhet të përbushin kandidatët për deputetë, mbështetur edhe në kërkesat ligjore dhe kriteret e integritetit e meritës për zgjedhjen në këto funksione publike.
3. Përfaqësuesit politikë të partisë në degën ekzekutive të qeverisjes dhe në funksionet e tjera publike politike mbajnë marrëdhënie të vazhdueshme dhe bashkëpunojnë me Grupin parlamentar socialist, Kryesinë e tij, Asamblenë Kombëtare, Kryesinë e partisë, Sekretarin e Përgjithshëm, Sekretariatit Ekzekutiv si edhe me antarët e partisë dhe zgjedhësit.

Kreu 9
PËRFAQËSUESIT E PARTISË NË ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Neni 53

Grupet e këshilltarëve socialistë

1. Këshilltarët e partisë të zgjedhur në bashki dhe qarqe përbëjnë grupin e këshilltarëve socialistë.
2. Grupet e këshilltarëve socialistë raportojnë për veprimtarinë e tyre në Asamblenë Socialiste të bashkisë dhe në Këshillin Koordinues të qarkut dhe bashkëpunojnë e mbajnë kontakte të vazhdueshme me komunitetin e bashkisë.
3. Veprimtaria konkrete, të drejtat dhe detyrat e antarëve, shkalla e autonomisë në vendimmarrje, marrëdhëniet midis Grupit të këshilltarëve dhe partisë përcaktohen në Librin e Rregullave.

Neni 54

Përfaqësuesit e partisë për kryetar bashkie dhe kryetar qarku

1. Partia zgjedh përfaqësuesit e saj për kandidatë për kryetar bashkie dhe kryetar qarku.
2. Kriteret që duhet të përmbushin përfaqësuesit për kandidatë për kryetar bashkie dhe kryetar qarku përcaktohen nga Statuti, mbështetur edhe në kërkesat ligjore dhe kriteret e inegritetit e të meritës për zgjedhjen në këto funksione publike.
3. Përfaqësuesit e partisë të zgjedhur kryetar bashkie dhe kryetar qarku mbajnë lidhje të vazhdueshme me organet drejtuese vendore të partisë, këshillat socialiste repektive si dhe me antarët e partisë dhe zgjedhësit.
4. Në Librin e Rregullave përcaktohen kriteret dhe procedura për përzgjedhjen e kandidatëve për këshilltarë të këshillit bashkiak dhe kandidatëve për kryetar të bashkisë.

Neni 55

Zgjedhja ndërmjet individëve kandidatë

1. Zgjedhja ndërmjet individëve kandidatë bëhet me vullnet të lirë dhe në mënyrë të fshehtë.
2. Antari i partisë, personalisht ose në cilësinë e delegatit, ka të drejtë të propozojë kandidatë ose të kërkojë heqjen e kandidatëve të paraqitur.
3. Kandidatët për antarë forumesh drejtuese të partisë për të gjitha nivelet i paraqiten me të dhëna të plota individuale për veprimtarinë konkrete profesionale e partiake mbledhjes që do të zgjedhë ndërmjet tyre.
4. Vlerësimi për çdo kandidat dhe vendimi për zgjedhjen ose moszgjedhjen e tij janë e drejtë ekskluzive e pacënueshme e zgjedhësit.
5. Kandidatëve u krijohet mundësi të barabarta për t'u shprehur e paraqitur në mjedisin përkatës. Antari i partisë ka të drejtë të mos pranojë kandidaturën e vet.
6. Vendet vakant në forumet drejtuese vendore e qendrore të partisë, në Komisionin e Garancive Statutore dhe Etikës dhe Komisionin e Zgjedhjeve të Partisë plotësohen me antarë të rinj sipas renditjes së votave të marra në listat e votuara për ta.

PJESA E PESTË
RREGULLAT PROÇEDURIALE TË PARTISË SOCIALISTE

Kreu 10
VENDIMARRJA NË PARTI

Neni 56
Zhvillimi i mbledhjeve në parti

1. Mbledhjet e partisë u krijojnë mundësi antarëve të diskutojnë për çështjet politike dhe të politikave, të forcojnë kontaktet midis tyre dhe të vendosin objektiva të reja për veprimtarinë e partisë.
2. Mbledhjet e partisë zhvillohen në një frymë miqësore, jashtë presioneve dhe diskriminimit të të gjitha llojeve, dhe nxisin pjesëmarrjen e sa më shumë antarëve legjitimë. Vendi dhe ora e mbledhjes duhet të jenë të aksesueshëm për të gjithë pjesëmarrësit.
3. Asambleja Kombëtare miraton një rregullore të posaçme për procedurat e zhvillimit të mbledhjeve të organizatave socialiste dhe forumeve drejtuese në nivel qendror, duke përcaktuar rregulla të qarta për thirrjen e mbledhjeve, kohën e zhvillimit, kuorumin e nevojshëm të pjesëmarrjes dhe të votimit, të drejtën e votës së antarëve, drejtimin e mbledhjeve dhe rregullat disiplinore.

Neni 57
Marrja e vendimit

1. PS është organizatë e debatit dhe e mendimit të lirë. Çdo vendim në organet dhe forumet e saj i nënshtrohet një diskutimi paraprak.
2. Vendimi merret me votim ose me konsensus.
3. Vendimi i miratuar me shumicë votash është i detyrueshëm për të gjithë pjesëtarët e organit që e merr dhe për ata të cilëve u referohet ai.
4. Pakica që ka votuar kundër, ka të drejtë të shfaqë pikëpamjet e saj në mbledhje ose në shtypin e partisë dhe të kërkojë rishqyrtimin e problemeve në organin drejtues më të lartë ose të ankimojë vendimin.

Neni 58
Zbatimi i vendimit

1. Sistemi i vendimmarrjes, i përcaktuar nëpërmjet këtij Statuti dhe rregulloreve të miratuara nga forumet drejtuese të partisë, është detyrimisht i zbatueshëm për të gjitha nivelet e strukturave të partisë.
2. Vendimi i organeve drejtuese vendore zbatohet nga antarët dhe nga organizatat socialiste. Vendimi mund të ankimohet pranë organit drejtues vendor që e ka marrë atë vendim ose pranë KGSE, kur çmohet se është në kundërshtim me Programin dhe Statutin e Partisë dhe Librin e Rregullave. Deri në sqarimin e çështjes, zbatimi i vendimit mund të pezullohet nga organet e mësipërme.
3. Vendimi i organeve drejtuese qendrore zbatohet nga organizatat socialiste dhe organet drejtuese vendore. Në rast mospajtimi me të, organizatat socialiste dhe organet vendore të

partisë kanë të drejtën e ankimimit pranë organit qendror vendimmarrës të partisë ose pranë Komisionit të Garancive Statutore dhe të Etikës.

4. Vendimin për arsye të përligjura e anulon vetëm struktura organizative e partisë që e ka marrë ose Komisioni i Garancive Statutore dhe Etikës.

5. Afatet dhe procedurat e kundërshtimit dhe ankimit të vendimit, përcaktohen në Librin e Rregullave.

Kreu 11 **VOTIMI DHE VOTËBESIMI**

Neni 59 **Votimi**

1. Votimi është vetiak. E drejta e votës nuk mund të delegohet.
2. Votimi për zgjedhjen midis kandidatëve për antarë të organeve drejtuese të partisë si rregull është i fshehtë dhe presupozon:
 - a. Të paktën më shumë se një kandidat mbi numrin e vendeve.
 - b. Kushte materiale që sigurojnë fshehtësi për votim individual.
 - c. Komision të posaçëm të përbërë nga antarë të partisë që nuk janë punonjës të aparateve të partisë dhe as me funksione drejtuese mbi ato që ka shumica e pjesëmarrësve në mbledhjen zgjedhëse.
 - ç. Përsëritje të zgjedhjeve për çdo shkelje të konstatuar në çast ose brenda një afati të arsyeshëm.
 - d. Ruajtjen e procesverbaleve të zgjedhjeve.
 - dh. Ruajtjen e fletëve të votimit për një afat kohor prej tre muaj, përveç rasteve kur për shkak ankimimi nevojitet më shumë kohë.
3. Zgjedhjet konsiderohen të vlefshme kur në to marrin pjesë jo më pak se 50 përqind plus një të antarëve të mbledhjes zgjedhore. I zgjedhur konsiderohet kandidati që ka marrë më shumë vota, por jo më pak se mbi 50 përqind të votave të vlefshme. Kur nuk arrihet nga asknjë kandidat ky minimum votash, zhvillohet raundi dytë i votimit ndërmjet dy të kandidatëve të renditur në krye. Në rast barazimi votash hidhet short. Zgjedhja e kandidatëve në listat shumëemrore që paraqiten për votim në organet vendore e qendrore të partisë bëhet me shumicë të thjeshtë të votave.
4. Rregullat për mënyrën dhe procedurat e votimit në të gjitha strukturat drejtuese të partisë përcaktohen në Librin e Rregullave.

Neni 60 **Votëbesimi**

1. Të zgjedhurit në të gjitha nivelet e forumeve drejtuese të partisë i nënshtrohen votëbesimit të zgjedhësve të tyre.
2. Të drejtën e iniciativës për mocion mosbesimi e ka përkatësisht 1/3 e antarëve të partisë, 1/3 e antarëve të organizatës socialiste, Asamblesë Socialiste të bashkisë, Asamblesë Kombëtare dhe delegatëve të Kongresit të partisë.

3. Mocioni i mosbesimit ndaj drejtuesve të partisë në nivel vendor inicohet në rastet kur:
 - a. Me vendim të Komisionit të Garancive Statutore dhe Etikës provohet se në veprimtarinë e tyre ka shkelje të rënda të Statutit të partisë.
 - b. Dëmton rëndë me veprime e qëndrime imazhin e partisë.
4. Gjashtë muaj para zgjedhjeve vendore ose zgjedhjeve të përgjithëshme dhe tre muaj para Kongresit nuk paraqiten mocione mosbesimi dhe nuk zhvillohen votëbesime.
8. Rregullat për mënyrën dhe procedurat e votbesimit në të gjitha strukturat drejtuese të partisë përcaktohen në Librin e Rregullave.

Neni 61

Referendumi dhe forma të tjera të konsultimit

1. Për probleme që prekin parimet themelore programore dhe statutore të partisë dhe procesin e përzgjedhjes së kandidaturave për qeverisjen qendrore e vendore zhvillohet referendum dhe procese konsultimi publik në parti. Disa prej akteve të organeve qendrore të partisë mund të jenë objekt i referendumit.
2. Referendumi zhvillohet me vendim të Kongresit të partisë, me propozim të Asamblesë Kombëtare, si dhe me kërkesë të Kryetarit të Partisë ose të 20% të antarësisë së partisë.
3. Referendumi njoftohet nga Sekretari i Përgjithshëm, pas konsultimit në favor të legjitimitetit të propozimit nga Komisioni i Garancive Statutore dhe Etikës.
4. Referendumi mund të jetë këshillues apo vendimmarrës. Nëse referendumi është vendimmarrës, vendimi i marrë është i pakthyeshëm, dhe nuk është subjekt i referendumit të mëtejshëm të brendshëm për të paktën katër vjet.
5. Rregullat kryesore dhe procedurat për zhvillimin e referendumit përcaktohen në Librin e rregullave.

PJESA E GJASHTË

MARRDHËNIET E PARTISË ME ORGANIZATAT POLITIKE E SHOQËRORE

Kreu 12

MARRDHËNIET ME ORGANIZMAT POLITIKË BRENDIA SAJ

Neni 62

Forumi i Rinisë Eurosocialiste të Shqipërisë (FRESH)

1. FRESH është organizëm politik që i asociohet strukturave të partisë, i cili bashkon të rinj e të reja antarë dhe përkrahës të partisë të moshës nga 14 - 30 vjeç.
2. Programi dhe veprimtaria e FRESH konvergojnë në përmbajtje me Programin, Statutin dhe veprimtarinë e partisë në tërësi.
3. FRESH ndërton strukturat e veta në nivel vendor e qendror. Drejtueset e FRESH duhet të jenë antare të partisë dhe hyjnë drejtpërdrejt në përbërje të organeve drejtuese të niveleve përkatëse të partisë.

13. Parimet kryesore, rregullat e përgjithshme organizative, proceduriale, funksionimi dhe përbërja e organeve drejtuese të FRESSH përcaktohen nga statuti i tij dhe miratohet nga Asambleja Kombëtare, duke u bazuar në parimin e bashkëdrejtimit të organeve, në të gjitha nivelet, nga një vajzë dhe një djalë.

Neni 63

Forumi i Grave Socialiste të Shqipërisë (FGSSH)

1. Forumi i Grave Socialiste të Shqipërisë është organizëm politik, i cili bashkon vajzat dhe gratë antare dhe përkrahëse të partisë, me synimin nxitjen dhe rritjen aksesin dhe kontributit të grave dhe vajzave në parti ,
2. Programi dhe veprimtaria e FGSSH konvergojnë me Programin, Statutin dhe veprimtarinë e partisë.
3. FGSSH ndërton strukturat e veta në nivel vendor e qendror. Drejtueset e FGSSH duhet të jenë antare të partisë dhe hyjnë drejtpërdrejt në përbërje të organeve drejtuese të niveleve përkatëse të partisë.
4. Parimet kryesore, rregullat e përgjithshme organizative, proceduriale, funksionimi dhe përbërja e organeve drejtuese të FGSSH përcaktohen nga statuti i tij dhe miratohet nga Asambleja Kombëtare .

Neni 64

Fondacioni “Qemal Stafa”

1. Pranë Partisë Socialiste ngrihet e funksionon Fondacioni “Qemal Stafa”.
2. Fondacioni “Qemal Stafa” mbështet me burime financiare, njerëzore, institucionale dhe teknike veprimtarinë e partisë.
3. Vizioni, misioni, vlerat themelore dhe mënyra e ndërtimit, funksionimit, objekti i punës, burimet e financimit të Fondacionit “Qemal Stafa” përcaktohen në Librin e Rregullave.

Kreu 13

MARRDHËNIET ME ORGANIZMAT TË TJERA DHE MEDIA

Neni 65

Mardhënia me organizatat e tjera

1. Partisë mund t'i asociohen organizata, shoqata, sindikata, fondacione dhe forma të tjera organizimi, të cilat pranojnë Programin, rregullat statutores dhe orientimet politike të partisë.
2. Nëpërmjet marrëveshjeve dhe formave të tjera të bashkëpunimit, partia mbështet e bashkëpunon me sindikatat, shoqatat, komunitetin akademik dhe me çdo organizim tjetër të ligjshëm që kanë afërsi programore me të.
3. Partia krijon dhe zhvillon lidhje bashkëpunimi me partitë dhe organizatat e tjera politike e shoqërore shqiptare jashtë kufijve shtetërorë të Republikës së Shqipërisë, në bazë të respektit të ndërsjellë, të mosndërhyrjes në punët e brendshme, e pavarësisht bindjeve politike dhe në interes të çështjes kombëtare, të zhvillimit të vendit dhe të mbrojtjes së të drejtave të shqiptarëve kudo që ndodhen.

4. Partia mban dhe zhvillon lidhje reciproke me partitë e Internacionales Socialiste, me Partinë e Socialistëve Europeanë dhe me gjithë partitë dhe forcat politike progresiste në botë.
5. Partia vendos marrëdhënie pune me universitete, institute, qendra kërkimore, institucione akademike, fondacione, shoqata kulturore jo-fitimprurëse, etj në të mirë të rritjes së formimit arsimor, kulturor dhe politik të anëtarëve të saj, dhe duke garantuar e respektuar autonominë e tyre
6. Rregullat e asociimit dhe të bashkëpunimit përcaktohen në Librin e Rregullave .

Neni 66

Shtypi dhe mjetet e tjera të partisë për informimin public

Organet e shtypit dhe mjetet e tjera për informim publik të partisë e bazojnë veprimtarinë e tyre në legjislacionin shqiptar, në Statutin dhe në Programin e partisë, duke ruajtur autonominë që siguron lirinë e informacionit dhe shprehjen e lirë të mendimeve.

PJESA E SHTATË FINANCAT, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I TYRE

Kreu 14

BURIMET FINANCIARE E MATERIALE

Neni 67

Burimet financiare e materiale

Të ardhurat financiare të partisë dhe të organizatave të saj përbëhen nga kuotat e antarësisë, burimet prej buxhetit të shtetit, ndihmat e antarëve, përkrahësve dhe votuesve të partisë, dhurata të ndryshme të ligjshme, të ardhura prej sipërmarrjeve që mbajnë dhe shfrytëzojnë asetet e saj si dhe nga të ardhurat e tjera, në përputhje me ligjet e shtetit.

Neni 67

Kuota e antarësisimit

1. Antarët e partisë paguajnë kuotën e antarësisimit. Masa e kuotës së antarësisimit dhe procedura e mbledhjes së saj përcaktohet nga Asambleja Kombëtare, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe aplikimit të përjashtimeve apo lehtësimeve për kategori të caktuara të antarëve.

2. Pagesa e paplotë ose mospagesa e kontributit që kërkohet, sipas masës së kuotës së vendosur nga Asambleja Kombëtare është shkak për marrjen e masave disiplinore sipas këtij Statuti.

Neni 68

Dhuratat

1. Dhuratat pranohen nga financierët e partisë dhe rregjistrohen në librin e mbajtjes së llogarive.
2. Për konfirmimin e pranimit të dhuratës përdoren formularët e miratuar nga Asambleja Kombëtare e partisë.

3. Nuk mund të pranohen dhuratat:
 - a. Nga ndërmarrjet publike.
 - b. Nga organizatat fetare.
 - c. Nga jashtë vendit ose shtetas të huaj jo anëtar të partisë, përveçse kur janë më pak se 1.000 Euro.
 - ç. Në pritje ose në këmbim të një avantazhi të caktuar ekonomik ose politik.
 - d. Nga individë apo organizata që nuk pranojnë të deklarohen.

Neni 69

Përdorimi i burimeve financiare e materiale dhe kontrolli i tyre

1. Për drejtimin dhe koordinimin e veprimtarisë financiare të partisë si dhe kontrollin mbi administrimin e tyre në të gjitha nivelet e strukturave të partisë funksionojnë financierët e partisë dhe audituesit e veprimtarisë financiare.
2. Organet kryesore financiare janë Kryefinancieri dhe Këshilli i Mbikqyrjes Financiare të partisë, të cilët zgjidhen nga Asambleja Kombëtare, me propozim nga Kryetari i partisë.
3. Detyrat, forma, afatet dhe mënyra e raportimit, organizimi, mandati, kriteret e Kryefinancierit, të Këshillit të Mbikqyrjes Financiare, dhe të financierëve në nivel vendor përcaktohen në Librin e Rregullave.

Neni 70

Transparenca financiare

1. Të gjithë kandidatët në listat e Partisë Socialiste, në përputhje me përcaktimin e legjislacionit mbi financimin e partive politike, kodin zgjedhor dhe legjislacionin tatimor, plotësojnë cdo deklaram paraprak, gjatë apo pas zgjedhjeve. Këshilli i Mbikqyrjes Financiare verifikon shpenzimet, transparencën dhe limitet e caktuara nga ligji dhe Rregullorja përkatëse e Asamblesë Kombëtare.

Neni 71

Auditimi ligjor

1. Një herë në katër vjet autorizohet kontrolli financiar mbi financat e partisë nga një firmë auditimi, e listuar dhe e parashikuar si e tillë nga legjislacioni shqiptar. Auditorët e pavarur, në mënyrë të veçantë, shprehin një opinion mbi financat, siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi.
2. Audituesi emërohet nga Kryesia e partisë. Raporti i audituesve ligjor i bashkëngjitet raportit të Këshillit të Mbikqyrjes Financiare gjatë paraqitjes së tij në Kongresin e rradhës.

PJESA E TETË
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 72

Hyrja në fuqi

1. Ky Statut hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kongresi i partisë.
2. Statuti i Partisë Socialiste, i miratuar në Kongresin e partisë më 19 Mars 2016, shfuqizohet.

Neni 73

Rregulloret e zbatimit

1. Brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e Statutit, Asambleja Kombëtare miraton Librin e Rregullave për zbatimin e tij. Rregulloret aktuale qëndrojnë në fuqi deri në miratimin dhe plotësimin e Librit të Rregullave, për aq sa nuk vijnë në kundërshtim me këtë Statut.
2. Ndryshimet në rregullat e përgjithshme nuk duhet të vijnë në kundërshtim me frymën, qëllimin dhe objektivat e partisë, të miratuara nga Kongresi.

Përgatitur:

Nga Komisioni për Reformën Statutore

Ngritur me vendimin nr. të AK të PS

Miratuar: Nga Kongresi zgjedhor i Partisë Socialiste, Tiranë, 29 Shkurt 2020
Pasqyruar në Nenin 40 “Zgjedhja e Kryetarit të Partisë”, pika 5, rezultati i referendumit në PS, dt. 9.4.2016.

[Shqiptaria .com]

[Shqiptaria .com]

[Shqiptaria .com]